

# Statusi i rezidentit afatgjatë në vendet e BE





# **Statusi i rezidentit afatgjatë në vendet e BE**

Mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian, Qeverisë Italiane dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

IOM nuk mban asnjë përgjegjësi për çfarëdo përdorimi që mund t'i bëhet informacionit që përmban ky material.

IOM i përmbahet parimit se migracioni i organizuar dhe human i shërben migrantëve dhe shoqërisë. Si një organizatë ndërqeveritare, IOM bashkëpunon me partnerët në komunitetin ndërkombëtar për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve aktuale të migracionit; për të zhvilluar më tej kuptimin e çështjeve që lidhen me migracionin; për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social nëpërmjet migracionit; dhe për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

© 2009 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shqipëri

---

*Të gjitha të drejta janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, regjistrohet, kopjohet ose transmetohet në çfarëdo formë apo me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose të tjerë, pa marrë më parë miratimin me shkrim nga botuesi.*

## Statusi i rezidentit afatgjatë në vendet e BE

Statusi i të huajve me qëndrim afatgjatë rregullohet nga Direktiva e Këshillit “Për statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë”. Statusi ligjor i shtetasve nga vendet e treta, dhe në mënyrë të veçantë i atyre me qëndrim afatgjatë, duhet të jetë i ngjashëm me atë të shtetasve të BE. Personat me qëndrim afatgjatë duhet të gëzojnë një sërë të drejtash sa më të ngjashme të jetë e mundur me ato të shtetasve të Shteteve Anëtare dhe duhet t’u ofrohet mundësia për të marrë shtetësinë e vendit ku ata kanë qëndrimin.

Elementët e parashikuar në Direktivën e Këshillit “Për statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë” janë bërë pjesë e legjislacionit të vendeve të BE.

Në vijim jepen dy shembuj të përfshirjes së këtyre elementëve në legjislacionin e Greqisë dhe Italisë.

### **STATUSI I REZIDENTIT AFATGJATË NË GREQI<sup>1</sup>**

#### *Kush mund ta fitojë statusin e rezidentit afatgjatë?*

Sipas ligjit, statusi mund të fitohet nga një shtetas i huaj në moshë madhore, i cili qëndron ligjërisht gjatë pesë viteve të fundit në Greqi. Periudhat e mungesës, nëse zgjasin më pak se gjashtë muaj të njëpasnjëshëm dhe nuk tejkalojnë, në total, një periudhë dhjetëmuajore brenda pesë vitesh, merren parasysh në përllogaritjen e periudhës pesëvjeçare.

<sup>1</sup>Marrë nga manuali për emigrimin e rregullt në Greqi, hartuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Çfarë kushtesh duhet të plotësojë një shtetas i huaj për të marrë statusin e rezidentit afatgjatë?

Shtetasi i huaj:

- duhet të zotërojë për vete dhe për të gjithë pjesëtarët e familjes në ngarkim burime të qëndrueshme dhe të rregullta të cilat vlerësohen sipas natyrës së tyre;
- duhet të ketë për vete dhe për të gjithë pjesëtarët e familjes në ngarkim një sigurim të plotë kundër sëmundjeve;
- duhet të ketë një strehim që plotëson specifikimet e kërkuara të higjienës;
- duhet të zotërojë mirë gjuhën greke;
- duhet të ketë njohuri mbi elementët e ndryshëm të historisë dhe kulturës greke.

*[Procedurat për çertifikimin e njohjes së gjuhës greke, si dhe të elementëve të historisë dhe kulturës greke, përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm, Administrimit Publik dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Arsimit Kombëtar dhe Fesë. Konfirmimi lidhur me plotësimin e kriterëve të paragrafit paraardhës bëhet nga Komiteti i Imigrimit i ngritur në çdo prefekturë të rajoneve. Kështu, Komiteti ka edhe dy anëtarë më shumë, që janë mësues të nivelit të dytë arsimor dhe që caktohen nga Drejtori i Arsimit të Nivelit të Dytë të Prefekturës].*

### Cilat kategori të huajsh nuk mund të fitojnë statusin e rezidentit afatgjatë?

Nuk mund të fitojnë statusin e rezidentit afatgjatë, pavarësisht plotësimit të periudhës pesëvjeçare të qëndrimit:

- mbajtësit e lejeve speciale të qëndrimit për qëllime studimi, përfitimi të trajtimeve mjekësore, si dhe për formim profesional;
- mbajtësit e lejeve të qëndrimit të cilat janë të natyrës së përkohshme, siç janë rastet e punësimit stinor, të shtetasve të huaj që lëvizin nga një kompani e vendosur në një shtet anëtar të BE-së apo Zonës Evropiane Ekonomike me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe të formimit profesional;
- personat që janë subjekt i Traktatit të Venecias (1961) për marrëdhëniet diplomatike.

### Kush e lëshon lejen e qëndrimit për rastet e statusit të rezidentit afatgjatë?

Organi kompetent për lëshimin e lejes së qëndrimit është organi që ka ripërtërirë lejen e qëndrimit para plotësimit të kushteve dhe kriterëve për fitimin e statusit të rezidentit afatgjatë.

### Çfarë dokumentash duhen paraqitur për marrjen e statusit të rezidentit afatgjatë, cila është procedura e ndjekur, si humbet ky status...etj?

Dokumentat që nevojiten:

1. një fotokopje e pasaportës ose një dokument tjetër udhëtimi;
2. një fotokopje e lejes së vlefshme të qëndrimit;

3. një fotokopje e shlyerjes së taksave për dy vitet e fundit. Të ardhurat vjetore duhet të jenë të paktën 8,500 Euro, plus 15 përqind (ose 1,275 Euro) për çdo pjesëtar familjeje në ngarkim (bashkëshort dhe/ose fëmijë) (referuar gjysmës së parë të vitit 2008);
4. një dokument i lëshuar nga zyra e taksave që deklaron se nuk keni taksa të papaguara;
5. një dokument i lëshuar nga fondi juaj i sigurimit social që deklaron se keni sigurim të plotë mjekësor dhe spitalor;
6. një dokument i lëshuar nga fondi juaj i sigurimeve shoqërore që deklaron se nuk keni ndonjë pagesë të pashlyer të Sigurimeve Shoqërore;
7. një fotokopje të kontratës së qerasë (e vërtetuar nga zyra e taksave) ose aktin zyrtar të zotërimit të banesës;
8. një provë të njohurive “të mjaftueshme” të gjuhës greke dhe historisë e kulturës greke. Kërkohej të paraqisni një certifikatë/vërtetim të lëshuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Arsimit të të Rriturve në Ministrinë e Arsimit. Duhet të përfundoni 100 orë mësimi të historisë dhe kulturës greke. Çertifikata lëshohet pas kalimit të një provimi në fund të programit;
9. një pagesë aplikimi prej 900 eurosh (referuar gjysmës së parë të vitit 2008);
10. tre fotografi me ngjyra të madhësisë për pasaportë.

### **Koha e shqyrtimit të kërkesës**

Zyrtarët kanë deri në gjashtë muaj kohë nga data e paraqitjes së kërkesës për ta miratuar ose refuzuar atë. Vendimi mund të vonohet me tre muaj, por vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.



### A mund të ripërtërihet statusi i rezidentit afatgjatë ?

Leja pesëvjeçare e qëndrimit mund të ripërtërihet për një pesëvjeçar tjetër me kusht që ju të paraqisni një kërkesë për ripërtëritjen. Kërkesat e aplikimit përfshijnë paraqitjen e një fotokopjeje të pasaportës suaj, ose të një dokumenti tjetër udhëtimi, dhe të një fotokopjeje të lejes suaj të qëndrimit. Ju duhet që, gjithashtu, të paraqisni tre fotografi pasaporte me ngjyra.

Në këtë rast zyrtarët kanë vetëm 15 ditë për të shqyrtuar aplikimin.

**Vini re:** përfundimi i lejes afatgjatë pesëvjeçare nuk është një arsye për dëbim ose për të hequr këtë status të veçantë.

### Në cilat raste autoritetet mund t'ia heqin emigrantit statusin e rezidentit afatgjatë?

Autoritetet kanë të drejtë t'ia heqin emigrantit këtë status në kushtet e mëposhtme:

- nëse është dëbuar nga vendi;
- nëse ka jetuar në vazhdimësi jashtë BE-së për 12 muaj ose më shumë;
- nëse ka jetuar vazhdimisht jashtë Greqisë për gjashtë muaj ose më shumë;
- nëse vlerësohet se paraqet kërcënim për rendin dhe sigurinë publike;
- nëse ka fituar statusin e rezidentit afatgjatë në një vend tjetër të BE-së.

**Vini re:** imigrantët që kanë humbur statusin e rezidentit afatgjatë, sepse kanë jetuar jashtë BE-së për më shumë se 12 muaj ose sepse kanë fituar të njëjtin status në

një shtet tjetër anëtar të BE-së, mund të aplikojnë për ta marrë atë përsëri. Procedura e aplikimit është e ngjashme me procedurën për lejen fillestare dhe pagesa e aplikimit është 450 euro (referuar gjysmës së parë të vitit 2008).

---

## STATUSI I REZIDENTIT AFATGJATË NË ITALI<sup>2</sup>

Leja e qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE që janë rezidentë afatgjatë zëvendësoi kartën e dikurshme të qëndrimit për këtë kategori shtetasish.

### Ndryshimet me lejen e thjeshtë të qëndrimit

Në ndryshim nga leja e thjeshtë e qëndrimit, leja e qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë, mundëson që:

- të hysh në territorin e vendit pa vizë dhe të lëvizësh lirisht në territor me përjashtim të ndalimit të parashikuar nga Prefekti;
- të ushtrosh në territorin e vendit çdo aktivitet punësimi, si punëmarrës apo i vetëpunësuar, veç atyre që ligji ia rezervon ekskluzivisht shtetasit italian, apo i ndalon për të huajt. Për ushtrimin e aktivitetit si punëmarrës nuk kërkohet lidhja e kontratës së qëndrimit për motive punësimi;
- të shfrytëzosh përfitimet e asistencës dhe të mbrojtjes shoqërore, ato të lidhura me fushën shëndetësore, shkollore dhe sociale, me qasjen ndaj mallrave dhe shërbimeve në dispozicion të publikut, përfshirë qasjen në procedurën për marrje

---

<sup>2</sup>Përgatitur nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

strehimi në ndërtesa publike banimi, përveç rastit kur parashikohet ndryshe;

- të marrësh pjesë në jetën publike vendore (lokale), sipas formave dhe kufizimeve të parashikuara me ligj.

Mbajtësi i lejes së qëndrimit për shtetas të huaj nga shtete jo-anëtare të BE, rezidentë afatgjatë, nuk mund të dëbohet nga territori italian, veçse për motive të rënda të rendit publik apo të sigurisë kombëtare, apo për përkatësi në organizata kriminale të tipit mafioz, ose të krimit të zakonshëm.

### Kriteret

Shtetasi i huaj:

- që është rezident në Itali të paktën prej pesë vitesh;
- që zotëron leje qëndrimi ende të vlefshme, e cila mundëson një numër të papërcaktuar ripërtëritjesh;
- që vërteton se realizon të ardhura të mjaftueshme për mbajtjen e vetvetes dhe të familjarëve që bashkëjetojnë me të në një shumë jo më të vogël se asistencë sociale (të ardhurat e realizuara një vit më parë se paraqitja e kërkesës në fjalë dhe që mund të dokumentohen në mënyrë objektive përmes deklaratimit të të ardhurave, apo në mungesë të tij, përmes listë pagesave, kontributeve të derdhura pranë INSP [Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore], faturave etj);
- që ka strehim të përshtatshëm, brenda parametrave minimalë të parashikuar nga ligji rajonal mbi strehimin në banesat publike, apo që ka paraqitur plotësimin e kërkesave mbi përshtatshmërinë higjieno-sanitare, të çertifikuara nga Enti Lokal i Shëndetësisë (ASL), kompetent për territorin;

mund t'i kërkojë Kuestorit kompetent për territorin, lëshimin e lejes së qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë.

Lejet e qëndrimit që mundësojnë një numër të papërcaktuar të ripërtëritjeve përfshijnë edhe lejet për motive punësimi si punëmarrës dhe si i vetëpunësuar (jo stinorë), për motive familjare, për hyrje të rasteve të veçanta.

Nuk përfshihen ata që:

- a. qëndrojnë për motive studimi apo formimi profesional;
- b. qëndrojnë për motive të mbrojtjes së përkohshme, për motive humanitare, apo që kanë paraqitur kërkesë për një leje të tillë dhe janë në pritje të një vendimi përfundimtar për kërkesën e tyre;
- c. qëndrojnë për motive azili, apo kanë kërkuar njohjen e statusi të refugjatit dhe ende janë në pritje të një vendimi përfundimtar lidhur me këtë kërkesë;
- d. zotërojnë leje qëndrimi afatshkurtër;
- e. gëzojnë statusin juridik parashikuar nga Konventa e Vjenës (1961) për Marrëdhëniet Diplomatike dhe nga Konventa e Vjenës (1963) për Marrëdhëniet Konsullore, nga Konventa (1969) për Misionet Speciale, nga Konventa e Vjenës (1975) për Përfaqësimin e Shteteve në Marrëdhëniet e Tyre me Organizatat Ndërkombëtare të Karakterit Universal.

Leja e qëndrimit për rezidentët afatgjatë nuk mund t'u lëshohet të huajve që konsiderohen të rrezikshëm për rendin publik apo sigurinë e shtetit.

## Mungesat

I huaji, që të ketë të drejtë për një leje qëndrimi për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së nuk duhet të mungojë në Itali apo BE për shumë kohë. Mungesat e të huajit nga territori italian nuk duhet të ndërpresin kohëzgjatjen e qëndrimit të parashikuar me ligj (pesë vjet) dhe përfshihen në përlogaritjen e kësaj periudhe kur janë më të shkurtra se gjashtë muaj të njëpasnjëshëm dhe në tërësi nuk tejkalojnë dhjetë muaj në periudhën pesëvjeçare.

## Pjesëtarët e familjes

Leja e Qëndrimit për rezidentët afatgjatë mund të kërkohet edhe për pjesëtarët e familjes që qëndrojnë rregullisht (ligjërisht) në Itali, përkatësisht:

- bashkëshort/e;
- fëmijë të mitur edhe të bashkëshortit/es, apo të lindur jashtë martesës, të pamartuar, me kusht që prindi tjetër, për sa kohë që ekziston, të ketë dhënë miratimin e tij;
- fëmijë të rritur në ngarkim, për sa kohë që s'mund të plotësojnë kërkesat e tyre të domosdoshme të jetesës për arsye të shëndetit të tyre;
- prindër në ngarkim, që nuk kanë mbështetje të përshtatshme në vendin e origjinës, apo të prejardhjes.

Për të kërkuar lejen edhe për pjesëtarët e familjes duhet provuar se plotësohen kërkesat e lartpërmendura mbi të ardhurat dhe strehimin.

Shtetasi/ja i/e huaj nga shtete jo-anëtare të BE-së i/e cili/a është pjesëtar/e i/e familjes dhe që bashkëjeton me një shtetas/e italian/e nuk mund të kërkojë këtë tip të lejes së qëndrimit por ai/a jo gëzon të drejtën e kërimit të Kartës së Qëndrimit të BE.

*Kërkesa për leje qëndrimi për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë*

Për të kërkuar këtë leje qëndrimi përdoren formularët e posaçëm që gjenden pranë zyrave postare. Formularët dërgohen në Kuesturën kompetente, duke bashkëngjitur:

- kopjen e pasaportës, apo të një dokumenti tjetër të barasvlershëm identifikimi të lëshuar nga autoriteti kompetent italian;
- kopjen e lejes së qëndrimit.

*[Nga këto dokumente duhet të dalin shtetësia, data dhe vendi i lindjes]*

- kopjen e deklaramentit të të ardhurave, lëshuar nga punëdhënësi, për vitin paraardhës, apo formularin e deklaramentit për punëtorët e vetëpunësuar;
- çertifikatën origjinale të regjistrimit gjyqësor dhe të akuzave në proces që merret pranë Zyrës së Regjistrimit Gjyqësor, në çdo Gjykatë Penale. Si rregull lëshimi i saj bëhet brenda një jave, me përjashtim të rasteve kur kërkohet lëshimi urgjent, çka sjell shpenzime shtesë;
- katër fotografi në format dokumenti;
- çertifikatë e strehimit të përshtatshëm.

Në rastin e kërkesës për leje edhe për pjestarët e familjes është e domosdoshme të paraqiten edhe:

- dokumentacioni që vërteton gjendjen familjare, i cili nëse është në gjuhë të huaj duhet të përkthehet dhe legalizohet pranë autoritetit diplomatik në vendin e origjinës së kërkuarit;
- çertifikata e përshtatshmërisë higjiëno-sanitare apo çertifikata e përshtatshmërisë së strehimit;
- dokumentat që vërtetojnë të ardhurat e kërkuara.

### Koha e lëshimit

Leja e qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, që janë rezidentë afatgjatë duhet të lëshohet brenda 90 ditësh nga paraqitja e kërkesës dhe është me kohë të papërcaktuar (e vazhdueshme).

### Kohëzgjatja

Leja e qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë, ka kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo është edhe një dokument identifikimi i vlefshëm për jo më shumë se pesë vjet (ashtu si një kartë identiteti). Në përfundimin e këtij afati, ajo mund të ripërtërihet, duke bashkëngjitur:

- kopje të pasaportës, apo të një dokumenti tjetër të barasvlershëm;
- katër fotografi format dokumenti;
- kopjen e deklaramentit të të ardhurave, lëshuar nga punëdhënësi, për vitin paraardhës, apo formularin e deklaramentit për punëtorët e vetëpunësuar.

## Shkaqet penguese për lëshimin e lejes së qëndrimit për rezidentët afatgjatë

Në prani të një prej shkeljeve penale të mëposhtme mund të refuzohet lëshimi i lejes së qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë.

Për shkelje të kryera apo në tentativë, si:

- kundër personalitetit të shtetit, për të cilën dënimi i parashikuar është burgimi jo më pak se pesë vjet dhe jo më shumë se dhjetë vjet;
- vjedhja me thyerje apo plaçkitja;
- kundër paprekshmërisë publike, për të cilën dënimi i parashikuar është burgimi me jo më pak se tre vjet dhe jo më shumë se dhjetë vjet;
- skllavërimi, prostitucioni i të miturve, pornografia e të miturve, nisma turistike me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të miturve;
- vjedhja me dhunë e sendeve, me përjashtim të rastit kur dëmi i pronësisë është me rëndësi të vogël;
- vjedhja me dhunë apo vjedhja në banesë;
- grabitja dhe shantazhi;
- fabrikimi, futja në shtet, vënia në shitje, kalimi, mbajtja në vende publike e armëve të luftës, eksplozivëve, armëve klandestine apo edhe armëve të zakonshme të zjarrit;
- prodhimi, shpërndarja, transportimi, mbajtja e substancave narkotike, nëse nuk hyn rrethana e sasisë së paktët;



- terrorizmi, cënimi i rendit kushtetues, për të cilin ligji parashikon dënim me burg, minimalisht pesë vjet dhe maksimalisht dhjetë vjet;
- promovimi, formimi, drejtimi dhe organizimi i organizatave apo grupeve që synojnë riorganizimin e partisë fashiste, apo që sidoqoftë kanë si qëllime të tyre nxitjen e diskriminimit racor, etnik, apo fetar;
- promovimi, organizimi, drejtimi i organizatave të tipit mafioz.

Po kështu refuzimi parashikohet për shkelje, si:

- përvetësimi përmes përfitimit nga gabimet e të tjerëve;
- dhuna, apo kërcënimi i një punonjësi publik;
- tregtimi i substancave ushqimore të dëmshme;
- lëndimet personale;
- vjedhja;
- dëmtimet e rënda;
- mashtrimi;
- përvetësimi i palejuar;
- modifikimi i armëve dhe fabrikimi i eksplozivëve.

### Anulimi

Leja e qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë anulohet:

- a. nëse është marrë me mashtrim;
- b. në rastin e dëbimit;
- c. kur mungojnë, apo do të mungojnë, kushtet për lëshimin e saj;

- d. në rastin e mungesës nga territori i BE-së për një periudhë 12 muajsh të njëpasnjëshëm;
- e. në rastin e lëshimit të një lejeje qëndrimi afatgjatë nga ana e një shteti tjetër anëtar të BE-së, përmes njoftimit nga ky i fundit dhe sidoqoftë në rastin e mungesës në territorin e Shtetit për një periudhë më të gjatë se gjashtë vjet.

### Ankimimi

Kundër vendimeve për refuzimin apo anulimin e lejes së qëndrimit për shtetas nga shtete jo-anëtare të BE-së, rezidentë afatgjatë, pranohet ankimimi pranë Gjykatës Administrative Rajonale kompetente brenda 60 ditësh nga marrja e njoftimit për vendimet e mësipërme.



Ky material u realizua në kuadër të projektit  
“Mbështetje për zbatimin e Strategjisë Kombëtare  
për Migracionin në Shqipëri”.

Ky projekt financohet nga **Bashkimi Evropian**  
dhe **Qeveria Italiane** dhe zbatohet  
nga **IOM** dhe **Qeveria Shqiptare**.

Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri  
Rruga e Durrësit, 127-1  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 222 8320  
Fax: +355 4 223 0752  
[www.delalb.ec.europa.eu](http://www.delalb.ec.europa.eu)

---

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)  
Rr. Brigada VIII, Vila Nr 3  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355 4 2257 836 / 7  
Fax: +355 4 2257 835  
[www.albania.iom.int](http://www.albania.iom.int)